

REFERAT

PËR ZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIN MËSIMOR-SHKENCOR E DREJTA CIVILE NË FAKULTETIN JURIDIK PRANË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Lidhur me Konkursin për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës, të shpallur më 04.05.2022 në gazetën ditore: Koha dhe Sloboden Pecat dhe në uebfaqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin E Drejta civile (50803 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), me propozim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik, Nr. 13-389/1 të datës 03.06.2022, formohet Komisioni recensues në përbërje:

1. Prof. Dr. Afet Mamuti – Kryetar
2. Doc. Dr. Shpresa Alimi-Memedi – Anëtare
3. Prof. Dr. Drita M. Fazlia – Anëtare

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar lidhur me Konkursin e lartpërmendur dhe në pajtueshmëri me Nenin 172 të Ligjit për Arsimin e Lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” Nr. 82/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e RSM-së” Nr. 178/2021), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës këtë:

RECENSION

Në Konkursin për zgjedhjen e një mësimdhënësi në lëmin E Drejta civile (50803 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, janë paraqitur kandidatët e mëposhtëm:

Kandidati I: Dr. Drita Bejtullahi, e lindur në Tetovë, e punësuar në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Tetovës dhe

Kandidati II: Dr. Irfan Tefiki, i lindur në f. Shipkovicë, i punësuar në Sektorin për mbrojtje, shpëtim dhe kriza në Komunën e Tetovës.

Kandidatja, Dr. Sc. Drita Bejtullahi në bashkëngjitje të aplikacionit për vendin e punës në fjalë (zgjedhje-rizgjedhje e një mësimdhënësi në lëmin E Drejta civile – 50803), ka dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme: thirrjen mësimore-shkencore, me Vendim të organit kompetent; diplomë për kryerjen e studimeve deridiplomike (Vendim për njohjen e kualifikimit të arsimit të lartë të kryer jashtë vendit); diplomë për kryerjen e studimeve të magistraturës;

diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet; dëshmi (transkriptë) me notat e fituara dhe mesataren nga të gjitha ciklet e studimeve; listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara; certifikata për pjesëmarrje në konferenca; biografi të shkurtër; punimin e doktoraturës; vërtetim për njohjen e gjuhës së huaj; certifikatë nga libri amë i të lindurve; certifikatë të shtetësisë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar nga kandidatët, Komisioni recensues paraqet përshkrimin në vazhdim:

Kandidati I: Dr. Drita Bejtullahi

1. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE SHKOLLIMI

Dr. Sc. Drita Bejtullahi është e lindur më 28.07.1979 në Tetovë. Shkollimin fillor e ka kryer në Shkollën Filllore Naim Frashëri në Tetovë, kurse atë të mesëm në Gjimnazin e Tetovës, me sukses të shkëlqyeshëm. Studimet universitare i ka kryer në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës në vitin 2006 dhe ka fituar titullin Juriste e diplomuar. Pas përfundimit të studimeve, ka qenë e punësuar në Administratën Shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Sekretariatën për Çështje Evropiane, gjatë një periudhe të vitit 2007. Nga viti 2008, kandidatja është në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Tetovës – Fakulteti Juridik, në pozitën e Bashkëpunëtores.

Karriera profesionale në Universitetin e Tetovës ka të bëjë me organizimin dhe zhvillimin e mësimdhënies praktike, si në Tetovë ashtu edhe në studimet e disperzuara të Fakultetit Juridik, në Shkup dhe Kërçovë. Përgjegjësitë dhe detyrat e përditshme i ka realizuar në bashkërendim të plotë me profesorin bartës të lëndës përkatëse dhe Departamentin e Fakultetit Juridik dhe Universitetin. Ka qenë e angazhuar kryesisht në lëndët e së Drejtës Civile, siç janë: E drejta civile, E drejta romake, reale, familjare, trashëgimore, E drejta e pronësisë industriale, etj.

Me qëllim të avancimit profesional akademik, ka regjistruar studimet e Ciklit të dytë – Magistraturë, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës në vitin akademik 2008/09. Kurse, tezën e Magistraturës me titull: “Paditë për mbrojtjen e pronësisë – Aplikimi i padive për mbrojtje të pronësisë (Actio Rei Vindicatio, Actio Publiciana dhe Actio Negatoria)” e ka mbrojtur në vitin 2013, duke fituar titullin Magjistër i së Drejtës Civile.

Ndërsa, studimet e Ciklit të tretë – Doktoraturë i ka ndjekur nga viti akademik 2014/15 në Fakultetin Juridik të Universitetit të Evropës Juglindore. Ato i ka kryer në vitin 2022, me mbrojtjen e Disertacionit të Doktoraturës me titull: “Analizë komparative e aspekteve ligjore në zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me theks të veçantë në Republikën e Maqedonisë” duke fituar titullin shkencor Doktor i Shkencave Juridike nga e Drejta Civile.

Gjatë punës së përditshme i është përkushtuar përfshirjes së plotë të studentëve në mësimin e lëndës dhe aktiviteteve të tjera përcjellëse, mentorimit të tyre gjatë punës praktike në institucione të tjera, orientimit të duhur në përgatitjen dhe prezantimin e punimeve seminarike, sikurse është angazhuar plotësisht në përgatitjen, organizimin dhe procesimin e provimeve dhe kollokuimeve dhe përpunimin e dokumentacionit të shfrytëzuar gjatë procesit të testimit.

2. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Drita Bejtullahi ka qenë e angazhuar me orar të plotë në mbajtjen e ushtrimeve në studimet e Ciklit të parë në Fakultetin Juridik, mbajtje të ligjëratave nën mentorimin e profesorit të lëndës përkatëse, angazhim të pjesshëm në ndihmesë të organizimit të studimeve të Ciklit të dytë, konsultime të rregullta me studentët e të gjitha viteve sipas orarit të paracaktuar mësimor.

Në vazhdim jepet lista e lëndëve të zhvilluara në kuadër të programit studimor dhe viteve akademike të angazhimit në Fakultetin Juridik:

2.1 Mbajtja e ligjëratave me mbulesë nga profesori bartës i lëndës në Ciklin e parë të studimeve

Viti akademik 2020/2021

- Semestri veror
E drejta e pronësisë industriale, ECTS 3, 2+1

Viti akademik 2019/2020

- Semestri veror
E drejta e pronësisë industriale, ECTS 3, 2+1

Viti akademik 2015/2016

- Semestri veror
E drejta reale (Kërçovë), ECTS 5, 2+1

2.2 Mbajtja e ushtrimeve në Ciklin e parë të studimeve

Viti akademik 2020/2021

- Semestri dimëror
E drejta romake, ECTS 5, 2+1
E drejta financiare, ECTS 7, 2+1
- Semestri veror
E drejta e arbitrazhit, ECTS 3, 2+1
E drejta e pronësisë industriale, ECTS 3, 2+1

Viti akademik 2019/2020

- Semestri dimëror
E drejta romake, ECTS 5, 2+1
E drejta financiare, ECTS 7, 2+1
- Semestri veror
E drejta ndërkombëtare private, ECTS 6, 2+1
E drejta e pronësisë industriale, ECTS 3, 2+1

Viti akademik 2017/2018

- Semestri dimëror
E drejta romake, ECTS 5, 2+1
E drejta administrative, ECTS 6, 2+1
E drejta ekologjike, ECTS 3, 2+1
Sociologjia e së drejtës, ECTS 4, 2+1

Viti akademik 2016/2017

- Semestri dimëror
E drejta romake, ECTS 5, 2+1
Sociologjia e së drejtës, ECTS 4, 2+1
- Semestri veror
E drejta reale, ECTS 5, 2+1
Qeverisja lokale, ECTS 3, 3+1

Viti akademik 2015/2016

- Semestri dimëror
E drejta romake, ECTS 5, 2+1
E drejta romake (Shkup), ECTS 5, 2+1
Sociologjia e së drejtës, ECTS 4, 2+1
- Semestri veror
E drejta reale, ECTS 5, 2+1
E drejta reale (Kërçovë), ECTS 3, 3+1

Viti akademik 2014/2015

- Semestri dimëror
E drejta civile, ECTS 6, 2+1
E drejta romake, ECTS 5, 2+1
- Semestri veror
E drejta e procedurës civile, ECTS 6, 2+1
E drejta reale, ECTS 5, 2+1
E drejta e shoqërive, ECTS 5, 2+1

Viti akademik 2013/2014

- Semestri dimëror
E drejta civile, ECTS 6, 2+1
E drejta romake, ECTS 5, 2+1
E drejta kushtetuese, ECTS 6, 2+1
- Semestri veror
E drejta reale, ECTS 5, 2+1
E drejta reale (Shkup), ECTS 5, 2+1
E drejta e procedurës civile, ECTS 6, 2+1

Viti akademik 2012/2013

- Semestri dimëror
E drejta civile, ECTS 6, 2+1
E drejta romake, ECTS 5, 2+1
- Semestri veror
E drejta reale, ECTS 5, 2+1
E drejta reale (Shkup), ECTS 5, 2+1
E drejta e procedurës civile, ECTS 6, 2+1

Viti akademik 2011/2012

- Semestri dimëror
E drejta civile, ECTS 6, 2+1
E drejta romake, ECTS 5, 2+1

E drejta romake (Kërçovë), ECTS 5, 2+1

- Semestri veror

E drejta reale, ECTS 5, 2+1

E drejta e procedurës civile, ECTS 6, 2+1

Viti akademik 2010/2011

- Semestri dimëror

E drejta civile, ECTS 6, 2+1

E drejta romake, ECTS 5, 2+1

E drejta romake (Shkup), ECTS 5, 2+1

- Semestri veror

E drejta reale, ECTS 5, 2+1

E drejta tregtare, ECTS 6, 3+1

Viti akademik 2009/2010

- Semestri dimëror

E drejta romake, ECTS 5, 2+1

E drejta romake (Kërçovë), ECTS 5, 2+1

E drejta familjare, ECTS 6, 3+1

Viti akademik 2008/2009

- Semestri dimëror

E drejta civile, ECTS 6, 2+1

E drejta romake, ECTS 5, 3+1

- Semestri veror

E drejta e procedurës civile, ECTS 6, 2+1

E drejta familjare, ECTS 6, 3+1

3. TË DHËNA PËR VEPRIMTARINË SHKENCORE–HULUMTUESE

Kandidatja ka botuar një numër punimesh shkencore në revista ndërkombëtare, si dhe ka marrë pjesë me prezantime në disa konferenca me pjesëmarrje ndërkombëtare të studiuësve, të cilat kanë të bëjnë me fushat me interes të studimit nga sfera e së Drejtës civile.

Punime të publikuara në konferenca dhe revista shkencore ndërkombëtare:

- Drita Bejtullahi, Teoritë për pronësinë në interpretimin e së drejtës së pronësisë intelektuale, *Balkan Journal of Interdisciplinary Research*, Vol. 8 | No.1 | 2022. IIPCCL Publishing, Graz-Austria, ISSN 2410-759X.
- Drita Bejtullahi, Industrial Application of Inventions and the Patent Approval, *Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences*. Vol. 7 | No. 3 | Nov, 2021. IIPCCL Publishing, Graz-Austria, ISSN 2410-3918.
- Merita Zulfiu-Alili, Blerta Ahmedi-Arifi, Drita Bejtullahi, Irregular Migration and Smuggling of Migrants along North Macedonia, *In Book of Proceedings of 2nd Online International Scientific Conference on Social and Legal Sciences (OISCSLS '20)*, pp. 217-226. SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY Faculty of Contemporary Social Sciences & Faculty of Law, Skopje. North Macedonia, 2021. ISBN 978-608-248-039-8.

- Drita Bejtullahi, Alba Robert Dumi, International Instruments Related to Industrial Property: An Empirical Analysis and a Case Study, *European Journal of Marketing and Economics*, Vol. 1 | Issue 2 | pp. 101–107, May–Aug 2018, ISSN 2601-8659 (Print) ISSN 2601-8667 (Online).
- Drita Bejtullahi, Alba Robert Dumi, Intellectual Property Law, Protection of the Rights, Its Importance in Our Country, *Mediterranean Journal of Social Sciences*, Vol. 8 | No 1 | 2017, ISSN 2039-2117 (Online) ISSN 2039-9340 (Print).
- Drita Bejtullahi, Fitimi i së drejtës së pronësisë (krahasimi i legjislacionit dhe sistemeve juridike përkatëse), *Anglisticum Journal (IJLLIS)*, Vol: 3 | Combined Issues: 8,9,10,11 and 12 | Tetova, Nov. 2014, e-ISSN: 1857-8187 • p-ISSN: 1857-8179.
- Drita Bejtullahi, Padia e rivendikimit dhe mundësia e kufizimit të saj, *JUSTICIA, International Journal of Legal Sciences*, Vol. 2 | No. 2 | Tetova, 2014.

Pjesëmarrje dhe prezantime në konferenca shkencore:

- Drita Bejtullahi, Participation on the 2nd Online International Scientific Conference on Social and Legal Sciences (OISCSLS '20), "Rule of Law, Governance and Society in the Time of Pandemic" South East European University, Skopje, 7 / 2021.
- Drita Bejtullahi, Participation on the "7th International Conference on Human and Social Sciences" 22-23 December 2017, Barcelona Spain (Online).
- Drita Bejtullahi, Participation on the "6th International Conference on Humanities and Social Sciences" 10th of December 2016, London UK (Online).
- Drita Bejtullahi, Participation on the International Scientific Conference: "Rule of Law and Democracy" organized by the Faculty of Law of State University of Tetova, March, 2014.
- Drita Bejtullahi, Participation on "Konferenca IV Interstudentore me Karakter Hulumtues dhe Shkencor" Qershor 2013, Prishtinë.

Mobilitet:

- Punë hulumtuese (mobilitet) në Bibliotekën Shkencore "Nermin Vlora Falaski" pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, RSh, 26.09.2018–14.02.2019.

4. TË DHËNA PËR VEPRIMTARINË ME INTERES MË TË GJERË

Drita Bejtullahi, përveç angazhimeve të rregullta në zhvillimin e procesit mësimor, shkencor dhe hulumtues, ka pasur edhe aktivitete shtesë të cilat bëjnë pjesë në veprimtarinë me interes më të gjerë, siç janë:

- Anëtare e Komisionit për transferim të studentëve në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, vitet akademike: 2011/12, 2012/13, 2015/16, 2016/17,
- Anëtare e Komisionit për verifikimin e dosjeve të diplomimit,
- Mentorimi i studentëve në punën praktike në Gjykatën e Tetovës dhe Komunën e Tetovës gatë viteve akademike 2014/15 dhe 2016/17,
- Pjesëmarrje në promovimin e Universitetit dhe ofertës akademike të tij,
- Pjesëmarrje në komisione dhe këshilla mësimorë në kuadër të Fakultetit Juridik që kanë të bëjnë me procesin arsimor dhe çështjet studentore,
- Pjesëmarrje në konferenca, forume, panele, promovime, jubilarë dhe aktivitete të tjera të rëndësishme të organizuara nga Universiteti i Tetovës dhe Universiteti i Evropës Juglindore, që kanë të bëjnë me çështje të arsimit të lartë, çështje juridike, apo çështje të tjera me interes.

Kandidati II: Dr. Irfan Tefiki

TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE SHKOLLIMI

Dr. Irfan Tefiki, i lindur më 04.10.1963 në f. Shipkovicë. Studimet deridiplomike i ka ndjekur në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe i ka përfunduar më 13. 04.1989, me notë mesatare 6.31, duke marrë titullin Jurist i diplomuar. Studimet e Ciklit të dytë – Magjistraturë i ka kryer më 25.11.2011 në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, me mbrojtjen e Punimit të magjistraturës me titull “Kontrata për mbajtje të përhjetshme” duke fituar titullin Magjistër në shkencat juridike. Studimet e doktoraturës i përfundoi më 11.03.2020, duke mbrojtur disertacionin me titull “Kontrata për rentë të përhjetshme në Republikën e Maqedonisë dhe në të drejtën krahasuese” në Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” në Universitetin Shën Kirili dhe Metodij dhe mori gradën Doktor i shkencave juridike. Në periudhën kohore 1997-2004, kandidati ka qenë i angazhuar si administrator publik, kurse nga viti 2004 është i punësuar në Komunën e Tetovës , në Sektorin për mbrojtje, shpëtim dhe kriza. Përveç gjuhës amtare–shqipe, kandidati është njohës i gjuhës maqedonase, serbe dhe angleze. Në dokumentacionin e tij, kandidati Dr. Irfan Tefiki nuk ka parashtruar të dhëna lidhur me veprimtarinë mësimore-arsimore, veprimtarinë shkencore-hulumtuese si dhe veprimtarinë me interes më të gjerë, prandaj për të nuk është paraqitur tabelë përkatëse për këto veprimtari (Formular 2).

PËRFUNDIM

Në bazë të kreut I dhe II, në konkurs janë paraqitur dy kandidatë. Sipas përshkrimit të lartshënuar për Kandidaten nga kreu I i këtij Referati dhe kushteve për zgjedhjen–rizgjedhjen e një mësimdhënësi në lëmin E Drejta civile (50803 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), sipas konkursit, kandidatja Dr. Sc. Drita Bejtullahi, në dokumentacionin e dorëzuar me fletaplikimin 04-03/13 të datës 09.05.2022, i plotëson kriteret ligjore sipas Ligjit për Arsimin e Lartë të RMV-së (18/2018) dhe i posedon të gjitha dokumentacionet e kërkuara në konkurs.

Kandidati Dr. Irfan Tefiki, në dokumentacionin e dorëzuar me fletaplikim nr. _____, nuk ka dorëzuar dëshmi për mesataren e arritur në ciklin e dytë të studimeve apo për të dy ciklet, që përbëjnë kushte dhe kriteret themelore për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore sipas Ligjit për Arsimin e Lartë të RMV-së (18/2018).

PROPOZIMI I KOMISIONIT RECENSUES

Komisioni recensues, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të parashtruar nga ana e kandidates dhe duke pasur parasysh që i njëjti është i plotësuar në bazë të kushteve të kërkuara për zgjedhje-rizgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, ka nderin që t'i propozojë Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës që:

Dr. Sc. Drita Bejtullahi të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore DOCENT, në lëmin E drejta civile (50803 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, Qershor 2022

KOMISIONI RECENSUES:

1. Prof. Dr. Afet Mamuti – Kryetar

2. Doc. Dr. Shpresa Alimi-Memedi – Anëtare

3. Prof. Dr. Drita M. Fazlia – Anëtare

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE–SHKENCORE, SHKENCORE, MËSIMORE–PROFESIONALE DHE THIRRJEN E BASHKËPUNËTORIT

Kandidati I: Dr. Drita Bejtullahi
Institucioni: Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës
Lëmi shkencor: E drejta civile (50803 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE–SHKENCORE – DOCENT

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Sukses mesatar prej së paku 8.00 (tetë) në studimet e Ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht, sukses të arritur mesatar prej të paktën 8.00 (tetë) në studimet e integruara të ciklit të parë dhe të dytë. Suksesi mesatar në Ciklin e parë të studimeve: 8.76 Suksesi mesatar në Ciklin e dytë të studimeve: 8.50 Suksesi mesatar në Studimet e integruara është: 8.63	Po
2	Titulli shkencor: Doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet Emri i lëmit shkencor: E drejta civile Fusha: Shkenca e së drejtës Sfera: Shkenca shoqërore	Po
3	Së paku katër punime shkencore të publikuara në botim shkencor referues në pajtueshmëri me LAL në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit.	Po
3.1	Një revistë shkencore në të cilën punimet që publikohen i nënshtrohen recensionit dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: EBSCO, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër e revistave të cilën do ta përcaktojë Këshilli Kombëtar për Arsimin e Lartë. 1. Emri i revistës shkencore: Academic Journal of Business, administration, Law and Social Sciences 2. Emri i databazës elektronike të revistës: EBSCO 3. Emri i punimit: Industrial Application of Inventions and the Patent Approval 4. Viti i publikimit: 2021	Po

3.2	<p>Një revistë shkencore në të cilën punimet e botuara janë të recensuara dhe e cila ka bord redaktues ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë anëtarë nga të paktën tre vende, dhe numri i anëtarëve nga një vend nuk mund të kalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i revistës shkencore: European Journal of Marketing and Economics 2. Bordi Redaktues Ndërkombëtar (numri i përgjithshëm i anëtarëve, numri dhe përkatësia sipas shtetit): Numri total–51, Shtete–29: Georgia, Turkey, Lithuania, Greece, Italy, Portugal, Albania, India, Bulgaria, Poland, Malaysia, Romania, Spain, Mongolia, Azerbaijan, Moldova, Russia, Finland, Egypt, Colombia, B&H, Indonesia, UK, Nigeria, UAE, Morocco, Chile, Mexico, Sri Lanka.. 3. Emri i punimit: <i>International Instruments Related to Industrial Property: An Empirical Analysis and a Case Study</i> 4. Viti i publikimit: 2018 	Po
3.3	<p>Revistë shkencore në të cilën punimet e publikuara janë të recensuara dhe që publikohet në një shtet anëtar të UE dhe/ose OBZhE.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i revistës shkencore: Mediterranean Journal of Social Sciences 2. Emri i anëtarit të BE/OBZhE: MCSER–Mediterranean Center of Social and Educational Research, published by: Richtmann Publishing Ltd in United Kingdom 3. Emri i punimit: <i>Intellectual Property Law, Protection of the Rights, Its Importance in Our Country</i> 4. Viti i publikimit: 2017 	Po
3.4	<p>Përmbledhje e punimeve shkencore të recensuara, të prezantuara në konferenca akademike ndërkombëtare ku anëtarët e bordit shkencor janë nga të paktën tre shtete.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emri i përmbledhjes: Book of Proceedings of 2nd Online International Scientific Conference on Social and Legal Sciences (OISCSLS '20) 2. Emri i Konferencës: Rule of Law, Governance and Society in the Time of Pandemic 3. Emrat e shteteve: Austria, Poland, Slovenia, Croatia, North Macedonia, etc. 4. Emri i punimit: Irregular Migration and Smuggling of Migrants along North Macedonia 5. Viti i publikimit: 2021 	Po
4	<p>Njohja e së paku një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të Universitetit.</p>	Po

	Gjuha e huaj: Angleze Emri i dokumentit: Vërtetim Publikuesi i dokumentit: Pointed Consulting Data e lëshimit: 01.03.2020 Gjuha e huaj: Angleze Emri i dokumentit: Certifikatë Publikuesi i dokumentit: Universiteti Popullor Data e lëshimit: 24.09.2008	
5	Ka aftësi për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë 1. Emri i Institucionit në të cilin janë fituar aftësitë për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë: Universiteti i Tetovës 2. Lloji i trajnimit / përvojës / arsimimit për përvetësimin e aftësive për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë: Mësimdhënie 3. Periudha e përvetësimit të aftësive për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë: 2008–2022	Po

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE–SHKENCORE, SHKENCORE, MËSIMORE–PROFESIONALE DHE THIRRJEN E BASHKËPUNËTORIT

Kandidati II: Dr. Irfan Tefiki
Institucioni: Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës
Lëmi shkencor: E drejta civile (50803 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE–SHKENCORE – DOCENT

Nr. rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Sukses mesatar prej së paku 8.00 (tetë) në studimet e Ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht, sukses të arritur mesatar prej të paktën 8.00 (tetë) në studimet e integruara të ciklit të parë dhe të dytë. Suksesi mesatar në Ciklin e parë të studimeve: 6.31 Suksesi mesatar në Ciklin e dytë të studimeve: _____ Suksesi mesatar në Studimet e integruara: _____	Jo
2	Titulli shkencor: Doktor i shkencave nga fusha shkencore në	Po

	të cilën zgjidhet Emri i lëmit shkencor: E drejta civile Fusha: Shkenca e së drejtës Sfera: Shkenca shoqërore	
3	Së paku katër punime shkencore të publikuara në botim shkencor referues në pajtueshmëri me Ligjin për Arsimin e Lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje.	Jo
3.1	Një revistë shkencore në të cilën punimet që publikohen i nënshtrohen recensionit dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: EBSCO, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër e revistave të cilën do ta përcaktojë Këshilli Kombëtar për Arsimin e Lartë.	Jo
3.2	Një revistë shkencore në të cilën punimet e botuara janë të recensuara dhe e cila ka bord redaktues ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë anëtarë nga të paktën tre vende, dhe numri i anëtarëve nga një vend nuk mund të kalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.	Jo
3.3	Revistë shkencore në të cilën punimet e publikuara janë të recensuara dhe që publikohet në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian dhe/ose OBZHE.	Jo
3.4	Përmbledhje e punimeve shkencore të recensuara, të prezantuara në konferenca akademike ndërkombëtare ku anëtarët e bordit shkencor janë nga të paktën tre shtete.	Jo
4	Njohja e së paku një gjuhe të huaj, e përcaktuar me akt të përgjithshëm të Universitetit. Gjuha e huaj: Angleze Emri i dokumentit: Certifikatë Publikuesi i dokumentit: American Corner Tetovo Data e lëshimit: Qershor 2014	Po
5	Angazhimi paraprak në veprimtarinë e arsimit të lartë Kandidati nuk ka qenë i angazhuar paraprakisht në procesin e mësimdhënies në ndonjë institucion të arsimit të lartë ose institucion tjetër arsimor.	Jo

FORMULARI 2**PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE–SHKENCORE,
SHKENCORE DHE MËSIMORE–PROFESIONALE**

Kandidati I: Dr. Sc. Drita Bejtullahi
Institucioni: Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës
Lëmi shkencor: E drejta civile (50803 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

VEPRIMTARIA MËSIMORE–ARSIMORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Mbajtja e ligjëratave me mbulesë nga profesori bartës i lëndës në Ciklin e parë të studimeve	
1.1	E drejta e pronësisë industriale, ECTS 3 (2+1)	2x15x3x0.04=3.6
1.2	E drejta reale – Kërçovë ECTS 5 (2+1)	2x15x5x0.04=6.0
2	Mbajtja e ushtrimeve në Ciklin e parë të studimeve	
2.1	E drejta romake, ECTS 5 (2+1)	1x15x5x0.03=2.25
2.2	E drejta civile, ECTS 6 (2+1)	1x15x6x0.03=2.70
2.3	E drejta familjare, ECTS 6 (3+1)	1x15x6x0.03=2.70
2.4	E drejta e procedurës civile, ECTS 6 (2+1)	1x15x6x0.03=2.70
2.5	E drejta reale, ECTS 5 (2+1)	1x15x5x0.03=2.25
2.6	E drejta ndërkombëtare private, ECTS 6 (2+1)	1x15x6x0.03=2.70
2.7	E drejta kushtetuese, ECTS 6 (2+1)	1x15x6x0.03=2.70
2.8	E drejta tregtare, ECTS 6 (3+1)	1x15x6x0.03=2.70
2.9	E drejta e arbitrazhit, ECTS 3 (2+1)	1x15x3x0.03=1.35
2.10	E drejta financiare, ECTS 7 (2+1)	1x15x7x0.03=3.15
2.11	E drejta administrative, ECTS 6 (2+1)	1x15x6x0.03=2.70
2.12	E drejta e pronësisë industriale ECTS 3 (2+1)	1x15x3x0.03=1.35
2.13	E drejta e shoqërive, ECTS 5 (2+1)	1x15x5x0.03=2.25
2.14	Sociologjia e së drejtës, ECTS 4 (2+1)	1x15x4x0.03=1.80
2.15	Qeverisja lokale, ECTS 3 (3+1)	1x15x3x0.03=1.35
2.16	E drejta ekologjike, ECTS 3 (2+1)	1x15x3x0.03=1.35
2.17	E drejta romake – Kërçovë, ECTS 5 (2+1)	1x15x5x0.03=2.25
2.18	E drejta reale – Kërçovë, ECTS 5 (2+1)	1x15x5x0.03=2.25
2.19	E drejta romake – Shkup, ECTS 5 (2+1)	1x15x5x0.03=2.25
2.20	E drejta reale – Shkup, ECTS 5 (2+1)	1x15x5x0.03=2.25
3	Mbajtja e konsultimeve me studentët	
3.1	E drejta romake, ECTS 5 (2+1)	87x0.002=0.174
3.2	E drejta civile, ECTS 6 (2+1)	82x0.002=0.164
3.3	E drejta familjare, ECTS 6 (3+1)	74x0.002=0.148
3.4	E drejta e procedurës civile, ECTS 6 (2+1)	75x0.002=0.15

3.5	E drejta reale, ECTS 5 (2+1)	69x0.002=0.138
3.6	E drejta ndërkombëtare private, ECTS 6 (2+1)	56x0.002=0.112
3.7	E drejta kushtetuese, ECTS 6 (2+1)	27x0.002=0.054
3.8	E drejta tregtare, ECTS 6 (2+1)	52x0.002=0.104
3.9	E drejta e arbitrazhit, ECTS 3 (2+1)	63x0.002=0.126
3.10	E drejta financiare, ECTS 7 (2+1)	18x0.002=0.036
3.11	E drejta administrative, ECTS 6 (3+1)	35x0.002=0.07
3.12	E drejta e pronësisë industriale ECTS 3 (2+1)	8x0.002=0.016
3.13	E drejta e shoqërive, ECTS 5 (2+1)	42x0.002=0.084
3.14	Sociologjia e së drejtës, ECTS 4 (2+1)	26x0.002=0.052
3.15	Qeverisja lokale, ECTS 3 (3+1)	23x0.002=0.046
3.16	E drejta ekologjike, ECTS 3 (2+1)	19x0.002=0.038
3.17	E drejta romake – Kërçovë, ECTS 5 (2+1)	37x0.002=0.074
3.18	E drejta reale – Kërçovë, ECTS 5 (2+1)	38x0.002=0.076
3.19	E drejta romake – Shkup, ECTS 5 (2+1)	28x0.002=0.056
3.20	E drejta reale – Shkup, ECTS 5 (2+1)	33x0.002=0.066
	Gjithsej	56.4

VEPRIMTARIA SHKENCORE–HULUMTUËSE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Teza të mbrojtura	
1.1	“Paditë për mbrojtjen e pronësisë – Aplikimi i padive për mbrojtje të pronësisë (<i>Actio Rei Vindicatio, Actio Publiciana dhe Actio Negatoria</i>)” – teza e magistraturës, Tetovë 2013.	/
1.2	“Analizë komparative e aspekteve ligjore në zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me theks të veçantë në Republikën e Maqedonisë” – teza e Doktoraturës, Tetovë 2022.	/
2	Punime të publikuara në revista dhe konferenca shkencore ndërkombëtare	
2.1	Drita Bejtullahi, Teoritë për pronësinë në interpretimin e së drejtës së pronësisë intelektuale, <i>Balkan Journal of Interdisciplinary Research, Vol. 8 No.1 2022. IIPCCL Publishing, Graz-Austria, ISSN 2410-759X.</i>	5.0
2.2	Drita Bejtullahi, Industrial Application of Inventions and the Patent Approval, <i>Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences. Vol. 7 No. 3 Nov, 2021. IIPCCL Publishing, Graz-Austria, ISSN 2410-3918.</i>	5.0
2.3	Merita Zulfu-Alili, Blerta Ahmedi-Arifi, Drita Bejtullahi, Irregular Migration and Smuggling of Migrants along North Macedonia, <i>In Book of Proceedings of 2nd Online International Scientific Conference on Social and Legal Sciences (OISCSLS '20), pp. 217-226. SOUTH EAST EUROPEAN</i>	2.0

	<i>UNIVERSITY Faculty of Contemporary Social Sciences & Faculty of Law, Skopje. North Macedonia, 2021. ISBN 978-608-248-039-8.</i>	
2.4	Drita Bejtullahi, Alba Robert Dumi, International Instruments Related to Industrial Property: An Empirical Analysis and a Case Study, <i>European Journal of Marketing and Economics, Vol. 1 Issue 2 pp. 101–107, May–Aug 2018, ISSN 2601-8659 (Print) ISSN 2601-8667 (Online).</i>	4.0
2.5	Drita Bejtullahi, Alba Robert Dumi, Intellectual Property Law, Protection of the Rights, Its Importance in Our Country, <i>Mediterranean Journal of Social Sciences, Vol. 8 No 1 2017, ISSN 2039-2117 (Online) ISSN 2039-9340 (Print).</i>	4.0
2.6	Drita Bejtullahi, Fitimi i së drejtës së pronësisë (krahasimi i legjislacionit dhe sistemeve juridike përkatëse), <i>Anglisticum Journal (IJLLIS), Vol: 3 Combined Issues: 8,9,10,11 and 12 Tetova, Nov. 2014, e-ISSN: 1857-8187 • p-ISSN: 1857-8179.</i>	5.0
2.7	Drita Bejtullahi, Padia e rivendikimit dhe mundësia e kufizimit të saj, <i>International Journal of Legal Sciences JUSTICIA, Vol. 2 No. 2 Tetova, 2014.</i>	5.0
3	Pjesëmarrje në konferenca shkencore me prezantim	
3.1	Drita Bejtullahi, 2 nd Online International Scientific Conference on Social and Legal Sciences (OISCSLS '20), "Rule of Law, Governance and Society in the Time of Pandemic" South East European University, Skopje, 7 / 2021.	2
3.2	Drita Bejtullahi, "7 th International Conference on Human and Social Sciences" 22-23 December 2017, Barcelona Spain (Online).	2
3.3	Drita Bejtullahi, "6 th International Conference on Humanities and Social Sciences" 10 th of December 2016, London UK (Online).	2
3.4	Drita Bejtullahi, International Scientific Conference: "Rule of Law and Democracy" organized by the Faculty of Law of State University of Tetova, March, 2014.	2
3.5	Drita Bejtullahi, "Konferenca IV Interstudentore me Karakter Hulumtues dhe Shkencor" 4 Qershor 2013, Prishtinë.	1
4	Mobilitet	
4.1	Punë hulumtuese në Bibliotekën Shkencore "Nermin Vlora Falaski" pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, RSh, 26.09.2018–14.02.2019.	1
	Gjithsej	40

VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Anëtare e Komisionit për transferim të studentëve në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, vitet akademike: 2011/12, 2012/13, 2015/16, 2016/17.	4*1=4
2	Anëtare e Komisionit për verifikimin e dosjeve të diplomimit.	2*1=2
3	Anëtare e komisionit për çështje studentore.	1
4	Pjesëmarrëse në promovimin e ofertës akademike të Universitetit të Tetovës.	2*1=2
5	Mentorimi i studentëve në punën e tyre praktike në Gjykatën Themelore të Tetovës 2014/15: dy grupe dhe në Komunën e Tetovës 2016/17: dy grupe.	4*1=4
	Gjithsej	13

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATES PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	PIKËT
VEPRIMTARIA MËSIMORE–ARSIMORE	56
VEPRIMTARIA SHKENCORE–HULUMTUESE	40
VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË	13
GJITHSEJ	109

Tetovë, Qershor 2022

KOMISIONI RECENSUES:

1. Prof. Dr. Afet Mamuti – Kryetar

2. Doc. Dr. Shpresa Alimi-Memedi – Anëtare

3. Prof. Dr. Drita M. Fazlia – Anëtare

RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES

Për zgjedhjen - rizgjedhjen e mësimdhënësit në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëminë
Policia dhe të drejtat e njeriut (51608 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencore -
hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në Fakultetin Juridik të Universitetit të
Tetovës

Në bazë të nenit 1 të Vendimit për formimin e Komisionit recensues me nr. 13-386/1 të datës 03.06.2022 nga Këshilli mësimor - shkencor i Fakultetit Juridik nga mbledhja e mbajtur më 03.06.2022, në përbërje:

1. Prof. Dr. Qebir Avziu - kryetar
2. Prof. Dr. Ali Musliu - anëtar
3. Prof. Dr. Muhamet Racaj - anëtar

në lidhje me Konkursin për zgjedhje - rizgjedhje të shpallur me datën 04. 05. 2022 në gazetën “Koha” dhe “Sloboden Pecat” si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës (www.unite.edu.mk/konkurse) për zgjedhjen e mësimdhënësi në thirje të Titulluar Docent në lëmin **Policia dhe të drejtat e njeriut (51608 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencore - hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**, Komisioni Recensues pas shqyrtimit të dokumentacionit për aplikim, konstatoi se:

Në Konkursin për zgjedhje - rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore - shkencore në lëmin **Policia dhe të drejtat e njeriut (51608 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencore - hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**, është paraqitur kandidati, si më poshtë:

Kandidati I: Dr. Latif Latifi i punësuar në marrëdhënie të rregullt pune si inspektor shtetëror për ambient jetësor në inspektoratin shtetëror për ambient jetësor

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve, Komisioni recensues, më poshtë paraqet këtë përshkrim:

Kandidati I: Dr. Latif Latifi

TË DHËNA BIOGRAFIKE PËR KANDIDATIN

Kandidati **Dr. Latif Latifi** ka lindur në f. Banjic e Poshtme - Gostivar më 06. 03. 1973. Shkollën fillore e ka mbaruar në Gostivar . Shkollën e mesme e kreu në gjimnazin “Pançe Poposki” në Gostivar, drejtimi bioteknologji në vitin 1991 dhe ka qenë nxënës i shkëlqyeshëm. Studimet deridiplomike i ka vijuar në fakultetin e Teknologjisë dhe Metalurgjisë – Shkup në Universitetin “Sh. Kiril dhe Metodij” dhe i përfundoi më 23.06.2013, me sukses 6.50, ku ka marrë titullin Inzhinjer i diplomuar i Teknologjisë ushqimore dhe Bioteknologjisë në Fakultetin e Teknologjisë dhe Metalurgjisë – Shkup. Gjithashtu kandidati kryen edhe studimet e dyta deridiplomike në Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës drejtimi Kimi me sukses 6.75 dhe fiton titullin Profesor i Diplomuar i kimisë.

Në vitin 2010 ka regjistruar studimet e magjistraturës në Fakultetin Komunikimeve dhe Teknologjive pranë Universitetit të Europës Jugë lindore - Tetovë, ku në afatin e paraparë i ka dhënë me sukses të gjitha provimet e parapara sipas planit të studimeve, me notë mesatare 9.00 . Punimin e magjistraturës me titull “Vlerësimi e statusit ekologjik të Liqenit të Mavrovës sipas direktivave të Europës” e ka përfunduar dhe mbrojtur me sukses më 05.10.2011 ku edhe ka fituar titullin Magjistër i menaxhimit të ambientit jetësor.

Studimet e ciklit të tretë ose të doktoraturës në Universitetin e “Sh. Kliment Ohridski” - Manastir, Drejtimi – Sigurim programi studimor Kriminalistik ekspert i Kriminalistikës teknike – Forenzikës në fakultetin e Shkupit. Me sukses përfundoi provimet me mesatare 9.14 dhe mbrojti me sukses disertacionin e doktoratës me titull ”Ekspertiza Situacionale e ujërave sipërfaqësor ne Republikën e Maqedonisë”, më datë 20.06.2018, me çrast mori gradën Doktor i shkencave nga lëmia e Sigurimit - Kriminalistik, me 180 ECTS.

Kandidati ka qenë i angazhuar si ligjerues në këtë vit aktual 2021/22 si Profesor në Fakultetin Juridik dega Kriminalistik në Universitetin e Tetovës. Njëkohësisht ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare në rajon dhe gjithashtu ka botuar disa punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

Në kuadër të programit për mobilitet, kandidati ka realizuar mobilitet edhe atë në Fakultetin e Sigurimit të Universitetit të Beogradit – Sërbi, (14-19 Mars, 2016). Përveç gjuhës amtare - shqipe, ai flet rrjedhshëm gjuhën maqedonase, angleze dhe turqishte.

1. TË DHËNA PËR VEPRIMTARINË MËSIMORE - ARSIMORE

Kandidati **Dr. Latif Latifi**, ka mbajtur ligjërata me mbulesë nga profesorët përkatës, ushtrime dhe konsultime në ciklin e parë të studimeve, në programet studimore të renditura si më poshtë:

Programi studimor: *Studimet e drejtësisë - Kriminalsitik*

- E Drejta policore
- Forenzika Psikopatologjike

2. TË DHËNA PËR VEPRIMTARINË SHKENCORE - HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati që nga regjistrimi i ciklit të tretë është angazhuar vazhdimisht në hulumtime shkencore në lëmin e sigurimit, kriminalistikës teknike – forenzikës, ekologjisë dhe më gjerë. Veprimtaria shkencore - hulumtuese përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare dhe me pjesëmarrje në tubime shkencore ndërkombëtare, të listuara më poshtë:

Punime të publikuara në konferenca dhe revista shkencore ndërkombëtare:

- **Latif Latifi**, Marina Malis Sazdovska - International, Institute for Private Commercial and Competition Law (IIPCCL) “Academic Journal of Business, Administration and Law and Social Sciences” – Tirana 2017
COMPARATIVE ANALYSIS OF ETHICAL CODES FOR STATE ADMINISTRATION IN R.MACEDONIA AND NEARBY STATES
Vol.3, No.1, - March 2017
ISSN 2410- 8693
IIPCCL Publishing, Vienna Austria www.iipccl.org
- **Latif Latifi**, Stojan Troshanski, Nikola Dujovski - International Yearbook “FACULTY OF SECURITY” – Skopje 2017/1
ETHICS IN THE APPLICATION OF SCIENTIFIC ACHIEVEMENTS WITH A SPECIAL ACCENT OF THE TECHNIQUES FOR CLIMATE CONDITIONS MODIFICATIONS AS A THREAT FOR THE WORLD SECURITY
ISSN 1857-6508
UDK: 551.583-049.5:17(100)
- **Latif Latifi**, Stojan Troshanski, Marina Malis Sazdovska- International Scientific Conference “SECURITY SYSTEM REFORMS AS PRECONDITIONS FOR EURO-ATLANTIC INTEGRATIONS” – Ohrid 2018
EQUIPMENT FOR FORENSIC ANALYSESS OF WATER QUALITY
Vol.3 June 2018
ISBN 978-608-4828-34-1 (T.3)
UDK: 628.1.032(497.7)
- **Latif Latifi**, Stojan Troshanski - International Scientific Conference “SECURITY, POLITICAL AND LEGAL CHALLENGES OF MODERN WORLD” – Bitola 2018
TECHNIQUES FOR MODIFICATION OF CLIMATE CONDITIONS AS A THREAT FOR ENVIRONMENTAL SECURITY
Vol.2 October 2018
ISBN 978-9989-870-79-8
UDK: 316.42.551.583-042.3

- **Latif Latifi**, Boris Murgoski, Marina Malis Sazdovska-International Scientific Conference “CRIMINALISTIC THEORY AND PRACTICES” – International Criminalistics Association – Zagreb 2018
FORENSIC ANALYSIS IN ENVIRONMENTAL CRIME
ISSN 1848-6164
- **Latif Latifi**, Marina Malis Sazdovska - 5TH International Scientific Conference “THE RULE OF LAW AND CIVIL SOCIETY ” – University of Tetova – 2019
BASIC SUBJECTS RESPONSIBLE FOR ENVIRONMENT SECURITY IN N.R MACEDONIA
Vol.7, No.12 December 2019
ISSN 1857-8454
UDC: 502/50435.075:502/504(497.7)
- **Latif Latifi**, Hasan Rustemi-International Scientific Conference “ MONEY IN POLITICS: REFLECTIONS, EXPETATIONS AND SOLUTIONS” – NDI and Aleksander Moisiu University – Durres 2019
CRIMINAL LEGAL ASPECTS OF CORRUPTION FROM POLITICAL PARTIES DURING ELECTION PROCESS IN R. MACEDONIA
ISBN 978-9928-267-13-9
- **Latif Latifi**, Marina Malis Sazdovska, Toni Mileski-International Scientific Conference “POLLUTION OF THE CITIES IN R.MACEDONIA: WHAT ARE THE SOLLUTIONS” – Macedonian Academy of Sciences and Art (MANU) – Skopje 2019
SITUATIONAL EXPERTISE OF SURFACE WATERS FOR PROHIBITION OF ENVIRONMENTAL CRIME IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA

ISBN 978-608-203-254-2
- **Latif Latifi**, Vasil Arminoski-International Scientific Conference “CRIMINALISTIC THEORY AND PRACTICES” – International Criminalistics Association – Zagreb 2019
APPLYING FORENSIC SKILLS TO DETERMINE THE ECOLOGICAL STATUS OR BIOTIC INDEX OF LAKE MAVROVO
ISSN 1849-6164
UDK: 343.983.2:502.172
- **Latif Latifi**, Hasan Rustemi -10TH International Scientific Conference ” THE GREAT POWERS INFLUENCE OF THE SECURITY OF SMALL STATES” – Ohrid 2019
PROCESSING THE SCENE OF ENVIRONMENTAL CRIME DURING SITUATIONAL EXPERTISE
ISBN 978-608-4828-47-1(T.2)
UDK:343.983.2
- **Latif Latifi**, Hasan Rustemi -3RD International Scientific Conference” TOWARDS SUSTIANABLE DEVELOPMENT” University Mother Teresa – Skopje 2019
ENVIRONMENT POLLUTION FROM WASTE IN THE MUNICIPALITY OF GOSTIVAR
- **Latif Latifi**, Hasan Rustemi 3RD International Scientific Conference” TOWARDS SUSTIANABLE DEVELOPMENT” University Mother Teresa – Skopje 2019
IMPORTANCE AND ECOLOGICAL STATUS OF MAVROVO LAKE FOR DEVELOPMENT OF TOURISM IN NATIONAL PARK MAVROVO

Ligjërata të mbajtura me ftesë të universitetit

- Ligjerata të realizuara në fakultetin e Sigurimit – Shkup, lënda Kriminalistika Ekologjike, tema veprat penale ekologjike dhe dënimet me 14.10.2014.
(<http://www.fb.uklo.edu.mk/faces/ACTIVITIES/activityview.xhtml?id=29>).
- Ligjerata të realizuara në fakultetin e Sigurimit – Shkup, lënda Kriminalistika dhe Shkenca për Policinë, tema CPTED – Crime Prevention through Environmental Design në vitin 2014.

(<http://www.fb.uklo.edu.mk/faces/ACTIVITIES/activityview.xhtml?id=51>).

- Ligjerata të realizuara në fakultetin e Sigurimit – Shkup, lënda Kriminalistika Ekologjike, tema Kontrolli gjatë inspektimit në ambient jetësor dhe në natyrë me 19.10.2015.
(<http://www.fb.uklo.edu.mk/faces/ACTIVITIES/activityview.xhtml?id=29>).

3. TË DHËNA PËR VEPRIMTARINË ME INTERES MË TË GJERË

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidati Dr. Latif Latifi, veprimtarinë me interes më të gjerë e ka zhvilluar si vijon:

1. Çertifikatë për trajnimin e kryer me sukses për aftësi “nga informatika teknologjike” Algoritam Centar – Shkup viti 2007.
2. Çertifikatë për trajnimin e kryer me sukses për aftësi “për informata të klasifikuara” Direkzioni për sigurim dhe informata të klasifikuara – Shkup viti 2020.
3. Licencë për inspektor shtetëror për ambient jetësor, Këshilli Inspektorial 14.04.2016.
4. Licencë për inspektor shtetëror për mbrojtjen e natyrës, Këshilli Inspektorial 06.07.2016.
5. Provimin e kryer me sukses për drejtimin dhe udhëheqjen e administratës, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratë – Shkup 26.07.2021.

4. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE - SHKENCORE

